

**Emertimi dhe Forma ligjore:**

**“NDERTIM MONTIMI E RE” sh.p.k**

**NIPT –i:**

**J73312211D**

**Adresa e Selise:**

**Elbasan**

**Data e krijimit:**

**22/08/1994**

**Nr. I Regjistrimit Tregtar**

**6025**

**Veprimtaria Kryesore:**

**Ndertim**

## **PASQYRAT FINANCIARE**

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr 2  
dhe Ligjit Nr. 25/2018, date 10.05.2018 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”)

### **VITI 2020**

Pasqyrat Financiare jane individuale

Pasqyrat Financiare jane te shprehura ne Lek

Pasqyrat Financiare nuk jane te rumbullakosura

Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare nga 01.01.2020-31.12.2020

Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare 03.03.2021

Pasqyra e Pozicionit Financiar	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
<b>AKTIVET</b>		
<b>Aktive afatshkurtra</b>		
Mjete monetare	16,078,664	64,259,167
Investime		
<i>Te tjera financiare</i>	0	0
<b>Te drejta te arketueshme</b>		
<i>Nga aktiviteti i shfrytezimit</i>	118,486,827	58,919,615
<i>Nga njesite ekonomike brenda grupit *</i>	0	0
<i>Te tjera</i>	2,853,329	4,183,990
<b>Inventaret</b>		
<i>Lende e pare dhe materiale te konsumueshme</i>	926,140	0
<i>Objekti banimi Reshit Collaku</i>	60,328,092	0
<i>Objekt Banimi nr 2</i>	60,831,552	66,550,808
<i>Objekt Banimi nr 3</i>	146,733,297	146,733,297
<i>AAGJM te mbajtura per shitje</i>	0	0
<b>Shpenzime te shtyra</b>	78,906,906	8,014,014
<b>Te arketueshme nga te ardhura te konstatuara</b>	0	0
<b>Totali i aktiveve afatshkurtra</b>	<b>485,144,806</b>	<b>348,660,891</b>
<b>Aktive afatgjate</b>		
<b>Aktive financiare</b>		
<i>Tituj te tjere te huadhenies</i>	0	0
<b>Aktive materiale</b>		
<i>Toka dhe ndertesa</i>	0	0
<i>Impiante dhe makineri</i>	0	0
<i>Te tjera instalime dhe pajisje</i>	2,048,960	1,219,508
<b>Aktivitet biologjike</b>	0	0
<b>Aktive jo materiale</b>		
<i>Emri i mire</i>	0	0
<b>Aktivitet tatimore te shtyra</b>	0	0
<b>Totali i aktiveve afatgjate</b>	<b>2,048,960</b>	<b>1,219,508</b>
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>	<b>487,193,766</b>	<b>349,880,399</b>

Administratori

Beqir Shehu



Pasqyra e Pozicionit Financiar	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
<b>DETYRIMET DHE KAPITALI</b>		
<b>Detyrime afatshkurtra</b>		
<i>Aktetime ne avance per porosi</i>	172,762,863	142,949,561
<i>Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit</i>	154,342,056	62,342,839
<i>Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsore</i>	704,341	220,618
<i>Te pagueshme per detyrime tatimore</i>	188,435	11,777
<i>Te tjera te pagueshme</i>	7,785,725	0
<b>Te pagueshme per shpenzime te konstatuara</b>	0	0
<b>Te ardhura te shtyra</b>	0	0
<b>Provizione</b>	0	0
<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra</b>	<b>335,783,420</b>	<b>205,524,795</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>		
<i>Titujt e huamarrjes</i>	0	0
<b>Te pagueshme per shpenzime te konstatuara</b>	0	0
<b>Te ardhura te shtyra</b>	0	0
<b>Provizione</b>		
<i>Provizione per pensione</i>	0	0
<b>Detyrime tatimore te shtyra</b>	0	0
<b>Totali i detyrimeve afatgjata</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Detyrime totale</b>	<b>335,783,420</b>	<b>205,524,795</b>
<b>Kapitali dhe Rezervat</b>		
<b>Kapitali i nenshkruar</b>	35,150,000	35,150,000
<b>Primi i lidhur me kapitalin</b>	0	0
<b>Rezerva rivleresimi</b>	0	0
<b>Rezerva te tjera</b>		
<i>Rezerva ligjore</i>	200,000	200,000
<i>Rezerva statutore</i>	0	0
<i>Rezerva te tjera</i>	109,005,604	91,969,581
<b>Fitimi/(humbja) e pashperndare</b>		
<b>Fitimi/(humbja) e periudhes</b>	7,054,742	17,036,023
<b>Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike</b>	<b>151,410,346</b>	<b>144,355,604</b>
<b>Interesa jo-kontrollues</b>		
<b>Totali i kapitalit</b>	<b>151,410,346</b>	<b>144,355,604</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>	<b>487,193,766</b>	<b>349,880,399</b>

Administratori

Beqir Shehu



	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
<b>Pasqyra e Performances (sipas natyres)</b>		
<b>Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit</b>		
<i>Te ardhurat nga aktiviteti kryesor</i>	8,293,841	51,589,463
<i>Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 1</i>	100,546,820	977,940
<i>Te ardhurat nga aktiviteti dytesor 2</i>	5,037,984	5,037,984
<i>Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit</i>	0	0
<b>Te ardhura nga ndryshimi ne inventarin e mallrave dhe prodhimit ne proces</b>	0	0
<b>Te ardhura nga puna e kryer nga njesia ekonomike per qellimet e veta dhe e kapitalizuar</b>	0	0
<b>Te ardhura te tjera te shfrytezimit</b>	0	0
<b>Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme</b>		
<i>Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme</i>	-8,908,575	-864,522
<i>Te tjera shpenzime</i>	-5,807,248	-29,565
<b>Shpenzime te personelit</b>		
<i>Paga dhe shperblime</i>	-4,095,173	-2,660,865
<i>Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore</i>	-683,898	-444,371
<b>Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale</b>	0	0
<b>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</b>	-325,097	-308,639
<b>Shpenzime te tjera shfrytezimi</b>	-84,770,067	-32,981,882
<b>Te ardhura te tjera</b>		
<i>Te ardhura nga njesite ekonomike brenda grupit*</i>	0	0
<b>Zhvleresim i aktiveve financiare dhe investimeve financiare te mbajtura si aktive afatshkurtra</b>	0	0
<b>Shpenzime financiare</b>		
<i>Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme</i>	-290,736	-63,752
<i>Shpenzime te tjera financiare</i>	-585,482	-177,999
<b>Pjesa e fitimit/(humbjes) financiare nga pjesmarrjet</b>	0	0
<b>Te tjera (pershkruaj)</b>	0	0
<b>Fitimi/(humbja) para tatimit</b>	<u>8,412,369</u>	<u>20,073,792</u>
<b>Tatimi mbi fitimin</b>		
<i>Tatimi mbi fitimin e periudhes</i>	-1,357,627	-3,037,769
<b>Fitimi/(Humbja) e periudhes/vitit (A)</b>	<u>7,054,742</u>	<u>17,036,023</u>
<b>Te ardhura te tjera gjithepershiresë per periudhen/vitin:</b>		
<i>Te tjera (pershkruaj)</i>	0	0
<b>Totali i te ardhurave te tjera gjithepershiresë per periudhen/vitin (B)</b>	0	0
<b>Totali i te ardhurave gjithepershiresë per periudhen/vitin (A+B)</b>	<u>7,054,742</u>	<u>17,036,023</u>

Administratori

Beqir Shehu



	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
<b>Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare (metoda indirekte)</b>		
<b>Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit:</b>		
Fitimi/(Humbja) e periudhes	8,412,369	20,073,792
Rregullime per te ardhura dhe shpenzime jo-monetare:		
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>	325,097	308,639
<i>Shpenzime te shytyra</i>	-70,892,892	29,630,735
<i>Shpenzime te tjera jo monetare</i>	0	317,728
Fluksi i mjeteve monetare i perfshire ne aktivite investuese		
<i>Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>	0	0
Ndryshim ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit		
Rënie/(ritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	-57,415,962	-12,271,940
Rënie/(ritje) në inventarë	-55,534,975	0
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	130,258,625	-14,111,044
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	0	0
<b>Mjete monetare neto nga/ perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit</b>	<b>-44,847,738</b>	<b>23,947,910</b>
Tatim fitimi i paguar gjate periudhes	-2,178,216	-524,538
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit</b>		
<i>Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>	-1,154,549	-111,000
<i>Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>	0	0
<i>Dividentë të arkëtuar</i>	0	0
<b>Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit</b>	<b>-1,154,549</b>	<b>-111,000</b>
<b>Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e financimit</b>		
<i>Dividendë të paguar</i>	0	0
<b>Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Rritje/(renie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente me to</b>	<b>-48,180,503</b>	<b>23,312,372</b>
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fillim	64,259,167	40,946,795
Efekti i luhatjeve te kurseve te kembimit te mjeteve monetare		
<b>Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fund</b>	<b>16,078,664</b>	<b>64,259,167</b>

Administratori

Beqir Shehu



Pasqyra e levizjeve ne kapitalin neto	Kapitali i nenshkruar	Rezerva te tjera (ligjore)	Rezerva te tjera	Fitim/(humbja) e periudhes	Totali
<b>Pozicioni financiar ne fillim</b>	<b>35,150,000</b>	<b>200,000</b>	<b>89,469,588</b>	<b>2,499,993</b>	<b>127,319,581</b>
Efkti i ndryshimeve ne politikat kontabile					0
<b>Pozicioni financiar i rideklaruar ne fillim</b>	<b>35,150,000</b>	<b>200,000</b>	<b>89,469,588</b>	<b>2,499,993</b>	<b>127,319,581</b>
<b>Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhes:</b>					0
Fitim/(humbja) e periudhes				17,036,023	17,036,023
Te ardhura te tjera gjithëperفشیرهse					0
<b>Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>17,036,023</b>	<b>17,036,023</b>
<b>Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:</b>					0
Emetim i kapitalit të nënshkruar					0
Percaktime te tjera per rezultatin e periudhes ( <i>pershkruaj</i> )			2,499,993	-2,499,993	0
<b>Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>2,499,993</b>	<b>-2,499,993</b>	<b>0</b>
<b>Pozicioni financiar ne fund (viti paraardhes)</b>	<b>35,150,000</b>	<b>200,000</b>	<b>91,969,581</b>	<b>17,036,023</b>	<b>144,355,604</b>
					0
<b>Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhes:</b>					0
Fitim/(humbja) e periudhes				7,054,742	7,054,742
Te ardhura te tjera gjithëperفشیرهse					0
<b>Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>7,054,742</b>	<b>7,054,742</b>
<b>Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:</b>					0
Emetim i kapitalit të nënshkruar					0
Percaktime te tjera per rezultatin e periudhes ( <i>pershkruaj</i> )			17,036,023	-17,036,023	0
<b>Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>17,036,023</b>	<b>-17,036,023</b>	<b>0</b>
<b>Pozicioni financiar ne fund (viti aktual)</b>	<b>35,150,000</b>	<b>200,000</b>	<b>109,005,604</b>	<b>7,054,742</b>	<b>151,410,346</b>

Administratori



**SHENIMET SHPJEGUESE****1. Informacion i përgjithshëm**

Shoqëria “NDERTIM MONTIMI E RE” sh.p.k është regjistruar pranë Zyres Se Rregjistrimit Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin Nr. 6025 datë 29/08/1994. Shoqëria ushtron aktivitet në fushën e ndertimeve civile dhe ka kapital të regjistruar prej 35,150,000 leke, i cili zotërohet nga ortakët i vetëm Z. Beqir Shehu. Shoqëria administrohet nga ortakët i vetëm i saj, Z. Beqir Shehu. Shoqëria më 31 dhjetor 2020 ka patur 14 të punësuar (31 Dhjetor 2019: 5 të punësuar)

Organizimi dhe funksionimi i saj rregullohet sipas ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008 “Per Tregtarët dhe shoqëritë tregtare” statutit të saj dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

**2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare****2.1 Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin Nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Në bazë të urdhrimit nr.64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

**2.2 Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

**2.3 Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

**2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

**2.5 Vlerësime dhe gjykime**

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

**2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve.

Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

### 2.5.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

### 2.6 Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.

## 3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### 3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2020	2019
Euro/LEK	123.70	121.77
USD/LEK	100.84	108.64

### 3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e



mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

- Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

- Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet.

Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

- Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

- Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

- Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

- Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

- Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi. Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivët financiarë të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivët financiarë të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

### 3.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

### 3.4 Aktive afatgjata material

#### i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivët afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

## iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyren	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

## iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

## 3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

## 3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

## 3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

## 3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

### 3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur për t’u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t’u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15% (2019: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet. Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

### 3.10 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

### 3.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

### 3.12 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

### 3.13 Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë q një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.



**Bilanci kontabel, aktivet**

**4. Aktive monetare**

Gjendja e aktiveve monetare ne date 31.12.2020 eshte ne shumen 16,078,664 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Aktive monetare	16,078,664	64,259,167
	<b>Shuma</b>	<b><u>16,078,664</u></b>	<b><u>64,259,167</u></b>

Difrencat e krijuara nga kurset e kembimit jane marre ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

**5. Te drejta te arketueshme**

Ne kete post paraqiten kerkesa ndaj te treteve te detajuara sipas tabelës se meposhtme, ne shumen 121,340,156 leke, me 31.12.2020.

Nr	Te drejta te arketueshme	Viti 2020	Viti 2019
1	Klient per shitje e sherbime	118,478,494	58,919,615
2	Tatim fitimi	1,029,245	208,656
3	Huadhenie	1,824,084	3,975,334
4	Parapagim per lidhje rrjeti uje kanalizime	8,333	-
	<b>Shuma</b>	<b><u>121,340,156</u></b>	<b><u>63,103,605</u></b>

**6. Inventarët**

Ne kete post paraqitet me 31.12.2020 shuma prej 268,819,080 leke, e perbere nga inventari i materialeve, punimet ne proces dhe parapagimet per inventar qe ka bere shoqeria, detajuar si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Materiale te para	926,140	-
2	Objekt banimi nr 2	60,831,552	66,550,808
3	Objekt banimi nr 3	146,733,297	146,733,297
4	Objekt banimi nr 4	60,328,092	-
	<b>Shuma</b>	<b><u>268,819,080</u></b>	<b><u>221,298,119</u></b>

**6.1 Lende e pare dhe materiale te konsumueshme**

Paraqitet vlere e materialeve te ndertimit gjendje me 31.12.2020, ne shumen 926,140 leke. Gjate vitit 2020 nuk eshte ndryshuar menyra e mbajtjes se inventarit e cila vazhdon te jete me kosto mesatare.

**6.2 Objekt banimi nr 2**

Paraqitet vlere e objektit te banimi Nr 2, Tirane, me 31.12.2020, ne shumen 60,831,552 leke.

**6.2 Objekt banimi nr 3**

Paraqitet vlere e objektit te banimi Nr 3, Tirane, me 31.12.2020, ne shumen 146,733,297 leke.

**6.2 Objekt banimi nr 4**

Gjate vitit 2020 shoqeria ka filluar ndertimin nje objekti banimi te ndodhur ne Rr. Rreshit Collaku, Tirane, vlere e te cilit me 31.12.2020, paraqitet ne shumen 60,328,092 leke.

**7. Shpenzime te shtyra**

Shpenzimet e shtyra paraqiten ne shumen 78,906,906 leke me 31.12.2020, te cilat i perkasin objekteve ne ndertim per vitin ushtrimor 2020. Te detajuara sipas tabelës se meposhtme:

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Pagesa per lejen e ndertimit/ te tjera objekti nr.4	74,528,141	3,635,249
2	Pagesa per lejen e ndertimit/ te tjera objekti nr.3	4,378,765	4,378,765
	<b>Shuma</b>	<b><u>78,906,906</u></b>	<b><u>8,014,014</u></b>

**Aktive afatgjata**

**8. Aktivët materiale**

Gjendja e aktiveve është paraqitur me vlerën kontabel të mbetur, me 31.12.2020 është 2,048,960 leke.

Nr	Aktive afatgjata materiale	Viti 2020	Viti 2019
1	Të tjera pajisje dhe informatike	2,048,960	1,219,508
	<b>Shuma</b>	<b><u>2,048,960</u></b>	<b><u>1,219,508</u></b>

Si politike kontabel për kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqëria ka zgjedhur modelin e kostos (SKK-5). Vlerësimi fillestar në momentin e hyrjes është bërë me kosto dhe në datën e mbylljes së bilancit paraqiten me koston e tyre minus zhvlerësimin e akumuluar dhe ndonjë humbje nga renia e vlerës. Drejtimi nuk ka llogaritur renie të vlerës për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019.

**Bilanci kontabel, pasivët**

**9. Detyrimet Afatshkurtra**

Paraqiten detyrime afatshkurtra të shoqërisë me 31.12.2020, në shumën 335,783,420 leke si më poshtë:

Nr	Detyrimet afatshkurtra	Viti 2020	Viti 2019
1	Arkëtime në avancë për porosi	172,762,863	142,949,561
2	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	154,342,056	62,342,839
3	Të pagueshme ndaj punonjësve e sigurimeve	704,341	220,618
4	Të pagueshme për detyrimet tatimore	188,435	11,777
5	Te tjera të pagueshme	7,785,725	-
	<b>Shuma</b>	<b><u>335,783,420</u></b>	<b><u>205,524,795</u></b>

**9.1 Arkëtime në avancë për porosi**

Në këtë post paraqitet shuma e parapagimeve nga klientët për shitjen e objekteve të banimit deri me 31.12.2020 në vlerën 172,762,863 leke.

**9.2 Te pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit**

Në këtë post paraqitet gjendja e furnitoreve të palikujduar me 31.12.2020 është 154,342,056 leke. Vlerat e tyre në monedha të huaja janë konvertuar me kursin e datës 31.12.2020 dhe diferencat janë kontabilizuar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas SKK-ve.

**9.3 Te pagueshme ndaj punonjësve e sigurimeve**

Paraqiten detyrime për paga të palikujduara e detyrimeve për sigurimet deri me 31.12.2020 gjithsej në shumën 704,341 leke, nga të cilat sigurime të muajit dhjetor në shumën 145,657 leke.

**9.4 Te pagueshme për detyrimet tatimore**

Detyrimet tatimore paraqiten në shumën 188,435 leke, të detajuara si më poshtë:

Nr	Detyrimet tatimore	Viti 2020	Viti 2019
1	Tatimi mbi të ardhurat personale	17,110	6,297
2	Tatim mbi vlerën e shtuar	165,756	5,480
3	Tatim në burim	5,569	-
	<b>Shuma</b>	<b><u>188,435</u></b>	<b><u>11,777</u></b>

9.5 Te tjera te pagueshme  
 Paraqiten detyrime te tjera te pagueshme me 31.12.2020 gjithsej ne shumen 7,785,725 leke.

### 10. Kapitali

Grupi kapitaleve te veta jane te paraqitura si me poshte:

Nr	Emertimi	Kapitali I nenshkruar	Rezerva ligjore	Rezerva te tjera	Fitimi I vitit	Totali
1	Gjendja me 31.12.2019	35,150,000	200,000	91,969,581	17,036,023	144,355,604
2	Shtesat per 2020	-	-	17,036,023	7,054,742	24,090,765
3	Paksimet per 2020	-	-	-	(17,036,023)	(17,036,023)
	<b>Gjendja me 31.12.2020</b>	<b><u>35,150,000</u></b>	<b><u>200,000</u></b>	<b><u>109,005,604</u></b>	<b><u>7,054,742</u></b>	<b><u>151,410,346</u></b>

Grupi i kapitaleve te veta eshte rritur me fitimin e vitit 2020 ne shumen 7,054,742 leke. Kapitali i regjistruar i shoqerise eshte 35,150,000 leke. Totali i grupit te kapitaleve te veta me 31.12.2020 eshte 151,410,346 leke.

### Pasqyra e Performances

#### 11. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit

Ne kete post jane rregjistruar te ardhurat e realizuara nga shoqeria per vitin 2020 ne shumen 113,878,645 leke, nga shitja e objekteve te banimit, ndertimi i objektit tek Rr. Reshit Collaku si edhe qeraja, sipas tabeles se meposhtme :

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Te ardhura nga shitja e objektit	8,293,841	51,589,463
2	Shitje e punimeve dhe e sherbimeve	100,546,820	977,940
3	Te ardhura nga qeraja	5,037,984	5,037,984
	<b>Totali i te ardhurave</b>	<b><u>113,878,645</u></b>	<b><u>57,605,387</u></b>

#### Sqarim per moskuadrimin e te ardhurave:

Sqarojme se moskuadrimi i te ardhurave te paraqitur ne FDP-te mujore ne shumen 143,620,436 leke me te ardhurat e paraqitura ne pasqyrat financiare ne shumen 113,878,645 leke, vjen si pasoje e paraqitjes se faturimeve te paradhenieve te arketuara nga klientet per shitjen e aparatamenteve ne shumen prej 29,813,302 leke, ne pasiv te pasqyrave financiare, ne postin “Arketime ne avance per porosi” si edhe humbjes nga kursi i kembimit ne Shumen 71,511 leke.

#### 12. Lende e pare dhe materiale te konsumueshme

Shuma e materialeve te konsumuara per vitin 2020 eshte 14,715,824 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Kosto e materialeve te konsumuara	8,908,575	864,522
	<b>Shuma I</b>	<b><u>8,908,575</u></b>	<b><u>864,522</u></b>
	<b>Te tjera shpenzime</b>		
1	Lidhje e energjise elektrike	-	29,565
2	Energji	87,992	-
3	Kosto e objektit te shitur	5,719,256	-
	<b>Shuma II</b>	<b><u>5,807,248</u></b>	<b><u>29,565</u></b>
	<b>Totali</b>	<b><u>14,715,824</u></b>	<b><u>894,087</u></b>

**13. Shpenzime te personelit**

Shpenzimet per koston e punes paraqiten ne shumen 4,779,071 leke si me poshte:

Nr	Kosto e Punes	Viti 2020	Viti 2019
1	Shpenzime per paga	4,095,173	2,660,865
2	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	683,898	444,371
	<b>Shuma</b>	<b><u>4,779,071</u></b>	<b><u>3,105,236</u></b>

Me poshte paraqitet permbledhesja e pagave per vitin 2020:

Nr	Muaji	Nr punonj	Paga Totale Bruto	Paga mbi te cilen llog. kontributet	Kontribut per sig. shoq.e shend Punedhnesi	Kontribut per sig. shoq.e shend Punemarresi	Tatimi ne leke	Paga neto
1	Janar	5	194,443	194,443	32,472	21,778	6,297	166,368
2	Shkurt	5	234,225	234,225	39,115	26,233	11,469	196,523
3	Mars	7	262,664	262,664	43,865	29,418	9,178	224,068
4	Prill	5	212,600	212,600	35,504	23,811	9,178	179,611
5	Maj	5	212,600	212,600	35,504	23,811	9,178	179,611
6	Qershor	8	281,466	281,466	47,005	31,524	9,178	240,764
7	Korrik	9	366,788	366,788	61,253	41,081	13,888	311,819
8	Gusht	10	403,079	403,079	67,315	45,145	14,658	343,276
9	Shtator	10	406,918	406,918	67,956	45,575	14,658	346,685
10	Tetor	13	484,088	484,088	80,844	54,219	15,810	414,059
11	Nentor	14	514,238	514,238	85,879	57,594	17,110	439,534
12	Dhjetor	14	522,064	522,064	87,186	58,471	17,110	446,483
	<b>Shuma</b>		<b><u>4,095,173</u></b>	<b><u>4,095,173</u></b>	<b><u>683,898</u></b>	<b><u>458,660</u></b>	<b><u>147,712</u></b>	<b><u>3,488,801</u></b>

Ne tabelen e meposhtme paraqitet informacion ne lidhje me shumen e shumën e pagave që u jepet për periudhën raportuese anëtarëve të organeve ekzekutive, drejtuese dhe mbikëqyrëse si edhe numrin mesatar të punëmarrësve gjatë periudhës raportuese, të zbërthyer sipas kategorive dhe kostot e personelit në lidhje me periudhën raportuese, të zbërthyer sipas pagave, kostove të sigurimeve shoqërore.

Nr	Pershkrimi	Nr punonj	Paga bruto	Paga per sig shoqerore	sig. shoq.e shendt punedhnes	sig. shoq.e shendt punemarres	Tap
1	Administrator	1	480,000	480,000	80,160	53,760	15,600
2	Specialiste te larte ndertimi	3	1,365,262	1,365,262	227,998	152,908	109,292
3	staf ndihmes	3	511,016	511,016	85,340	57,235	6,310
4	punetore	12	1,738,895	1,738,895	290,401	194,758	16,510
	<b>Shuma</b>		<b><u>4,095,173</u></b>	<b><u>4,095,173</u></b>	<b><u>683,898</u></b>	<b><u>458,660</u></b>	<b><u>147,712</u></b>

**14. Shpenzime Konsumi dhe Amortizimi**

Paraqitet amortizimi i aktiveve afat gjata materiale per vitin 2020 ne shumen 325,097 leke, i llogaritur sipas normave ne fuqi.



Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Amortizim asetesh	325,097	308,639
	<b>Shuma</b>	<b><u>325,097</u></b>	<b><u>308,639</u></b>

**15. Shpenzime te tjera shfrytezimi**

Jane paraqitur shpenzime ne shumen 84,770,067 leke per vitin 2020, te cilat jane te detajuara si ne tabelen e meposhtme:

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Kancelari	13,008	4,800
2	Sherbim kontabiliteti, noterie	491,125	524,912
3	Shpenzime telefonike	23,675	17,250
4	Kosto e objektit te shitur	-	31,341,790
5	Taksa lokale	915,460	564,043
6	Komisione bankare	76,061	53,076
7	Shpenzime riparimi	30,000	26,620
8	Shpenzime mirembajtje kompjuterash	5,040	6,000
9	Qera	447,375	443,391
10	Sherbim per transport dhe depozitim mbetjesh	11,744,876	-
11	Germim + largim mbejtresh	27,594,839	-
12	F.V tubo celiku me flanaxha	1,627,833	-
13	Punime per ndertim anker	11,003,713	-
14	Punime Skelerie	310,426	-
15	Punime hekur/beton	28,845,088	-
16	Shpenzime ngritje kantieri	1,159,133	-
17	Analiza betoni / hekuri	38,192	-
18	F.V Konstruksion Metalik	363,230	-
19	F.V Rrethimi	28,000	-
20	Shpenzime te tjera konsumi personal	52,994	-
	<b>Shuma</b>	<b><u>84,770,067</u></b>	<b><u>32,981,882</u></b>

**Sqarim per kuadrimin e shpenzimeve te deklaruar ne FDP mujore me shpenzimet e raportuara ne Pasqyrat Financiare te vitit 2020**

Nr	Sipas FDP	Shuma ne leke
1	Blerje nga furnitore vendas	93,116,831
2	Blerje te perjashtuara	62,525,340
3	Blerje investimi brenda vendit pa tvsh	18,580
4	Blerje investimi brenda vendit	1,135,970
	<b>Totali I blerjeve</b>	<b><u>156,796,721</u></b>
Nr	Sipas bilancit	
1	Lende e pare dhe materiale te konsumueshme	9,834,715
2	<i>korigjohet me Ndryshimin e gjendjes</i>	(926,140)
3	Te tjera shpenzime	5,807,248
4	Shpenzime te tjera shfrytezimi	84,770,067



5	Blerje AQT	1,154,549
	<b>Shuma</b>	<b><u>100,640,439</u></b>
<b>Nr</b>	<b>Diferenca fdp-bilanc e detajuar si me poshte</b>	<b>56,156,282</b>
1	Kalim ne kosto objekti per tu shitur viti 2019	(60,328,092)
2	Kosto e objektit te shitur, rimarrje	5,719,256
3	Parapagime te bera	(8,333)
4	Shpenzime per tu shperndare	(1,604,487)
5	Taksa lokale	915,460
6	Komisione bankare	76,061
	<b>Diferenca</b>	<b><u>0</u></b>

### 16. Shpenzime financiare

Paraqiten shpenzime financiare per vitn 2020 ne shumen 876,218 leke, te detajuara si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Fitim/Humbje nga kembimet valutore	(290,736)	(66,137)
2	Te ardhura nga interesat	-	2,386
	<b>Shuma I</b>	<b><u>(290,736)</u></b>	<b><u>(63,752)</u></b>
1	Gjoha e penalitete	(3,660)	(111,492)
2	Shpenzime per tatim qeraje	(67,106)	(66,507)
3	Humbje nga mosarketim klienti	(508,116)	-
4	Shpenzime pa fature te rregullt tatimore	(6,600)	-
	<b>Shuma II</b>	<b><u>(585,482)</u></b>	<b><u>(177,999)</u></b>
	<b>Totali</b>	<b><u>(876,218)</u></b>	<b><u>(241,751)</u></b>

### 17. Llogaritja e tatimit te fitimit

Shoqeria per vitin ushtrimor 2020 paraqitet me Fitim neto ne shumen 7,054,742 leke. Te permbledhura te ardhurat dhe shpenzimet e periudhes, paraqiten si me poshte:

Nr	EMERTIMI	VITI 2020	VITI 2019
1	Te ardhura	113,878,645	57,605,387
2	Shpenzime	(105,466,276)	(37,531,595)
3	<b>Rezultati</b>	<b><u>8,412,369</u></b>	<b><u>20,073,792</u></b>
4	Shpenzime te pazbritshme	638,475	177,999
5	<b>Rezultati per llogaritjen e tatim fitimit</b>	<b><u>9,050,844</u></b>	<b><u>20,251,791</u></b>
6	Perqindja e tatim fitimit	15	15
7	Tatim fitimi	1,357,627	3,037,769
8	<b>Fitimi neto i periudhes</b>	<b><u>7,054,742</u></b>	<b><u>17,036,023</u></b>

Shpenzimet e pazbritshme ne shumen 638,475 leke jane shpenzime te detajuara si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2019
1	Shpenzime per tatim ne burim	67,106	66,507
2	Gjoha e penalitete	3,660	111,492
3	Humbje nga mosarketim klienti	508,116	-
4	Shpenzime pa fature te rregullt tatimore	6,600	-
5	Shpenzime te tjera konsumi personal	52,994	-
	<b>Shuma</b>	<b><u>638,475</u></b>	<b><u>177,999</u></b>

**18. Angazhime dhe pasiguri****Çështje gjyqesore**

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2020 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, qe mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

**19. Ngjarje pas datës së Bilancit**

Situata e krijuar gjate periudhes se fatkeqesise natyrore, te shpallur si pasoje e COVID-19, nuk ndikon ne biznesin tone dhe si pasoje nuk prek parimin e vijimesise, i cili merr parasysh se Shoqëria do te vazhdoje ekzistencen e aktivitetit te saj per nje te ardhme te parashikuar.

**Administratori****Beqir Shehu**